

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 18, 1 – 7 Maj 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEK, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 18

	JAVA 18
DIARRE PA GJAK	1.828
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	6.857
INF. RESP. TE POSHTËME	3.053
RASH ME TEMPERATURË	11
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	0
Numri i Njësive Raportuese	400
% e Njësive Raportuese	93% (400/427)

Rash me temperaturë

9 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit dhe 2 raste nga rrethi i Tiranës. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rrethit, rastet nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë.

Shpërthim i një sëmundjeje të ngjashme me sëmundjen Dorë-këmbë-gojë, Grabian – Lushnje.

Në javën e parë të muajit Maj në fshatin Grabian të rrethit të Lushnjes ndodhi një shpërthim i një sëmundjeje me ekzantemë makulo-pauloze dhe vezikulare në duar, këmbë dhe gojë e ngjashme me sëmundjen Dorë-këmbë-gojë, në fëmijë të kopështit dhe të ciklit të ulët të shkollës, si edhe në fëmijë të tjerë në komunitet. Të gjithë fëmijët kishin shenja të njëjta të lezioneve kutane të paraprirë në fillim të sëmundjes, me temperaturë dhe dhimbje koke. Deri tani janë identifikuar 34 fëmijë me shenjat e sëmundjes. Index case e ka fillimin e sëmundjes në datën 25 Prill 2017. Mosha mesatare dhe mediane e fëmijëve është 5 vjeç por që varion në 0-9 vjeç. Vetëm 2 fëmijë janë të moshës <1 vjeç, përkatësisht 9 muajsh dhe 10 muajsh. Të gjithë fëmijët janë nga fshati i Grabianit. Koha nga dita e njoftimit deri në ditën e hetimit të shpërthimit ishte <24 h.


Gjatë hetimit epidemiologjik u morrën mostra të feceve, tamponë rektale, tamponë të fytyrës dhe materialeve kutane, të cilat po testohen në laboratorin e Virologjisë në ISHP.

Duke u bazuar në numrin e rasteve, në periudhën e inkubacionit të sëmundjes dhe në periudhën e infektueshmërisë u vendos: Mbyllja e kopështit për 1 periudhë 1 javore duke filluar nga data 10.05.2017 deri në datën 16. 05. 2017.


Duhet të rritet vëmendja dhe të përforcohet survejanca e rashit me temperaturë në institucionet parashkollore dhe shkollore si edhe në komunitete sidomos për raste të kësaj sëmundje dhe të kryhet raportimi i menjëhershëm në ISHP.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet rënie në javën e 18 krahasuar me javën paraardhëse, java e 17.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet ritje në javën e 18 krahasuar me javën paraardhëse, java e 17.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 - 18 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.




Në javën e 18-të të vitit 2017 vërehet një trend në rënie i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 4% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën 18-të të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)





Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000




Numri i rasteve të Infeksioneve Respiratore Akute (IRA) ka kaluar pragun epidemik.

Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 17 dhe 18 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 01 - 18 të vitit 2016 dhe të vitit 2017. Numri i rasteve.

Në javën e 18-të të vitit 2017 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarreve pa gjak” dhe ky numër është 29% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 17 dhe javën 18 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)

Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 18 sipas rretheve, në përqindje.